




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-0/DPK
Nr. Prot. 01-1410/2012
Br. Prot. 01
Data 19.04.2012
Datum 19.04.2012
Date
PRISHTINE

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	18.04.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Ragip Sabotic Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Kompaninë Rajonale- Hidrodrini-Pejë
CC:	z. Shkëlzen Hyseni Drejtor Menaxhues i KRU" Hidrodrini"- Pejë
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Furnizimi me naftë (euro dizel)"



I nderuari z. Sabotic

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin " Furnizimi me derivate të naftës ". nr. prokurimi 701-12-011-121 ofron këtë:

OPINION

Ju si autoritet kontraktues Zyra Prokurimit – Kompania e Ujësjiellësit Rajonal " Hidro – Drini" SH.A Pejë t'i ndërmerni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetim, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

Arsyetim

Zyra e prokurimit në Kompaninë e Ujësjiellësit Rajonal " Hidro – Drini" SH.A Pejë , si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Furnizim " të procedurës së hapur kontrata publike kornizë me nr. të prokurimit Hidro-12-011-121 me titull "Furnizimi me naftë (euro dizel) , në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit te neni 2.1 i Dosjes së tenderit te Qëllimi kontratës për Lloto II – është kërkuar që kontraktori duhet të posedoj pompa për furnizim ne qendrat regjionale (Pejë, Istog dhe Klinë) ose duhet të ketë marrëveshje me nga një pompë për furnizim për secilin regjion. Distanca e pikave të shitjes duhet të jetë **max 5 km** nga objektet e KUR " Hidro Drini" për pikën e Pejës (nga Drejtoria) dhe **max 5 km** për qendrat tjera nga objektet e KUR " Hidro Drini", nga kjo rrjedh se departamenti prokurimit ka bërë diskriminim territorial gjë që paraqet shkelje të **nenit 7 pika 4 LPP-së 04/L-042.**

Me respekt!